



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

Nr. 73/2 prot.,

Datë 12.01.2024

**FORMULAR PËR PUBLIKIM**  
**LIDHUR ME ARSYET E SKUALIFIKIMIT NË RASTIN E ANKESAVE PËR**  
**VENDIMIN E VLERËSIMIT/KLASIFIKIMIT PËRFUNDIMTAR**

**Objekt:** Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “ALMedical” SHPK në procedurën e prokurimit “E hapur” me Nr. REF-86618-11-07-2023 me objekt “Blerje pajisje laboratorike për Institutin e Ndërtimit”, me fond limit 29,540,333 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 30.11.2023 nga autoriteti kontraktor Agjencia Shtetërore e Prokurimeve të Përqëndruara.

**Ankimues:** Operatori ekonomik “ALMedical” SHPK me NIPT K21511002I dhe adresë Rruga Shefqet Musaraj, Banesa nr. 17, Tiranë.

**Autoriteti Kontraktor:** Agjencia Shtetërore e Prokurimeve të Përqëndruara me adresë Blv. “Dëshmorët e Kombit”, Nd. 1, 1001, Tiranë.

Në datën 11.01.2024 nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me numër ankimi elektronik A/2024/3750 dhe me nr. 73/2024 prot., datë 11.01.2024 e operatorit ekonomik “ALMedical” SHPK për procedurën e prokurimit “E hapur ” me me Nr. REF-86618-11-07-2023 me objekt “Blerje pajisje laboratorike për Institutin e Ndërtimit”, me fond limit 29,540,333 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 30.11.2023 nga autoriteti kontraktor Agjencia Shtetërore e Prokurimeve të Përqëndruara.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua se objekti i saj lidhet me kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, mbi skualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “ALMedical” SHPK, nga procedura e prokurimit të sipërcituar.

Bazuar në nenin 112, pika 4, gërma “b” të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: “Në mënyrë që ankesa të bëhet e aksesueshme jo vetëm nga autoriteti ose enti kontraktor, por njëkohësisht edhe nga operatorët ekonomikë të interesuar, KPP-ja publikon: b) arsyet e skualifikimit në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar;”, Komisioni i Prokurimit Publik do të publikojë arsyet e skualifikimit të operatorit ekonomik “ALMedical” SHPK.

Konkretisht në ankesë ngrihen pretendime mbi arsyet e skualifikimit si më poshtë vijon:

### **Arsyet e skualifikimit:**

*Operatori Ekonomik “ALMEDICAL” SH.P.K. S’kualifikohet*

*-Operatori ekonomik nuk plotëson kërkesat sipas Shtojces 5 të DST “Specifikimet Teknike “dhe pikës 4 të Seksionit 2.3 “Kapaciteti Teknik” të Kërkesave të Vecanta për Kualifikim, pasi specifikimet e pajisjeve të ofruara në kataloget e paraqitura, nuk plotësojnë specifikimet teknike të kërkuara nga Autoriteti Kontraktor si vijon:*

*I. (Zeri Nr.1 Spec Teknike) Presa Automatikë Multifunksionale për Betonin: Nuk është i pajisur me kitin për proven e shperthimit. Në specifikime pajisja kërkohej të jetë e pajisur me kitin për proven e shperthimit. Në katalog është percaktuar vetëm kodi 50-C9000/C i cili shërben për testimin në terheqje me ane të ndarjes së mostrave vetëm për mostrat cilindrike. Pajisja duhet që të perdoret për testimin në terheqje me ane të ndarjes për mostrat cilindrike, në kubat e betonit dhe blloqet e betonit. Nuk është perzgjedhur (markuar) aksesori i cili ben të mundur proven për testimin në terheqje me ane të ndarjes së mostrave për kubat e betonit dhe blloqet e betonit. Pa këte aksesor prova në terheqje me ane të ndarjes për blloqet e betonit nuk është e mundur të kryhet. Printeri i cili shërben për printimin e rezultateve të provave, nuk është zgjedhur tek aksesoret e paraqitura në katalog. Në specifikime është kërkuar që pajisja të shoqerohet sëbashku me printerin termik. Në katalog nuk percaktohet nëse softëare është i afte të bëjë shfaqjen e njëkohshme të ngarkesës, stresit, raportit aktual të ngarkesës, grafikun ngarkese-kohe, grafikun stres-lodhje, zhvendosjen dhe zgjatimin në %, grafikun stress/zgjatjen në %. Pajisja automatike e kontrollit (njësia qendrore e kontrollit automatik) e cila është e pajisur dhe softëare i cili ben të mundur kontrollin e presës në mënyrë automatike duhet që të zotërojë një ekran në të cilin të mund të jipen kontrollet si dhe të shfaqen rezultatet në kohe reale të testimëve. Njësia qendrore e kontrollit automatik nuk zotëron një ekran të tillë por duhet të lidhet me PC.*

*II. (Zeri Nr.3 Spec Teknike) Prese për provat në terheqje të celikut dhe percaktimin e rezistencës në perkulje të celikut: Pajisja duhet të kryejë proven e perkuljes dhe ri-perkuljes për mostrat me diametër  $\geq 42\text{mm}$ . Në katalog nuk paraqitet aksesori i cili ben të mundur proven e perkuljes dhe të riperkuljes për mostrat me diametër  $\geq 42\text{mm}$ . Pajisja pa aksesoret e nevojshme e ka të pamundur të kryejë proven e perkuljes dhe të riperkuljes. Të këte mundësi për elemente ngarkese me diametër nga  $\leq 16$  deri  $\geq 320\text{mm}$ . Pajisja duhet të përmbajë minimalisht elementet e ngarkesës me diametër 16, 20, 24, 30, 32, 42 mm. Në katalog nuk janë paraqitura elementet e ngarkesës të*

*cilet sigurojne qe qe te kryhet prova e perkuljes dhe e riperkuljes minimalisht per diametrat e mesiperm. Pa elementet e ngarkeses nuk mund te kryhet prova e perkuljes dhe e riperkuljes.*

*III. (Zeri Nr.4 Spec Teknike) Aparat Vikat.Duhet te paraqitet numri i gjilperave ballore (initial needle) te cilat zoteron seti. Duhet qe te paraqitet diapazoni i termometrit te qelqit i cili ka temperature maximale deri ne 110°C. Duhet te paraqitet diapazoni I sakte ne menyre qe te vleresohet nese plotesohet diapazoni minimal i kerkuar nga -10°C deri ne +50°C.*

*IV. (Zeri Nr.4 Spec Teknike) Tavoline per konsistencen e llacit: Nuk ka nje numerues dixhital i cili tregon numrin e rrotullimeve goditjeve dhe kohen e percaktuar.*

*V. (Zeri Nr.8 Spec Teknike). Peshore Analitike 200gr (0,0000): Sipas broshures se katalogut nuk specifikohen standardet me te cilat eshte konform peshorja. Gjithashtu edhe nga broshura e shkarkuar ne internet nuk figurojne standardet EN ose ekuivalent te jene konform me peshoren. Pajisja e ofruar ka devijim lineariteti tipik +/- 0.2mg, ndersa specifikimet e kerkuara nuk e lejojne devijimin e linearitetit tipik me shume se 0.06mg.*

*VI. (Zeri Nr.13 Spec Teknike). Byreta Dixhitale: Pajisja duhet te kete precision  $\leq 0.2$  %. Pajisja e ofruar nuk e ploteson kete kusht pasi ka precision +/- 0.6%, me te madh se kufiri i lejuar.*

*VII. (Zeri Nr.20 Spec Teknike). Klasifikues i Mostrave me kapacitet te madh: Kapaciteti mbajtes eshte 20L, nuk i permbush kushtet e specifikimeve qe duhet te jete te pakten  $28dm^3=28L$ . Gjithashtu nuk percaktohet diametri i limit i materialeve te cilat mund te klasifikohen, edhe pse hapësira maksimale e hapjes eshte 100mm cka nenkupton qe materialet me madhesi mbi 100mm deri ne 150mm nuk mund te klasifikohen. Nuk plotesohet diapazoni i materialeve te cilat klasifikohen qe duhet te jete nga 15-150mm sipas specifikimeve te kerkuara.*

*VIII. (Zeri Nr.22 Spec Teknike). Peshore: Te specifikimet e paraqitura per peshoren nuk eshte percaktuar nese ajo eshte ne perputhje me standardin EN932-5, ose standardi ekuivalent me te cilin eshte ne perputhje pajisja.*

*IX. (Zeri Nr.27 Spec Teknike). Pajisje per percaktimin e peshes specifike te aggregateve te trasha: Ne specifikimet e katalogut thuhet qe shumica e peshoreve jane te pajisura me nje aksesori (ganxhe ose grep) per te kryer testin e peshes specifike (peshime me varje). Ne specifikime nuk percaktohet nese peshorja e perzgjedhur e zoteron nje aksesori te tille per te kryer peshime me varje te cilat jane kusht thelbesor per kete pajisje.*

*X. (Zeri Nr.28 Spec Teknike) Balon Le Chatelier. Ne specifikime eshte percaktuar qe saktesia e Balonit Le Chatelier te jete 0.05ml. Ne katalogun e paraqitur nuk eshte paraqitur saktesia e Balonit Le Chatelier.*

*XI. (Zeri Nr.31 Spec Teknike) Kape Kimike: Te specifikimet e paraqitura per peshoren nuk eshte percaktuar nese ajo eshte ne perputhje me standardin EN932-5, ose standardi ekuivalent me te cilin eshte ne perputhje pajisja.*

*XII. (Zeri Nr.7 Spec Teknike) Unaza Le Chatelje. Kiti I paraqitur ne katalogun teknik, nuk specifikon numrin e kerkuar per unazat dhe pjatat e xhamit sipas specifikimeve teknike. Ne specifikime jane kerkuar 6 unaza dhe 12 pjata xhami, ndersa kiti I markuar ofron 3 unaza dhe 6 pjata xhami. Sasia e dy aksesoreve me siper nuk saktosohet te formulari i ofertes.*

*-Operatori ekonomik nuk plotëson kërkesat sipas Shtojces 7 të DST “Kërkesat e Vecanta Per kualifikim, pika 2 e Seksionit 2.3 “Kapaciteti Teknik” të Kërkesave te Vecanta per Kualifikim. Në këtë pikë është kërkuar se: “Operatori ekonomik ne lidhje me artikujt objekt prokurimi te percaktuar shtojcën 6 Formulari i sasisë dhe Grafiku i ekzekutimi, qe do te paraqese, duhet te plotësoje tabelën e mëposhtme duke specifikuar vendin e origjinës si dhe certifikimet te leshuara nga nje organ i autorizuar për specifikimet e pajisjeve te ofruara ne kataloget e paraqitur”. Referuar Dokumentit mbi origjinën dhe Certifikimet, të paraqitur nga Al-Medical sh.p.k, në tabelën përkatse rezulton se ka deklaruar se do të dorëzojë Certifikatë Konformiteti për artikujt 7,12,15,18,19,25,26,27,28. Për të gjitha artikujt e tjerë operatori ka referuar se janë të pajisura me Deklaratë të Konformitetit, fakt i cili vjen në kundërshtim me përcaktimet e pikës 2 ku përcaktohet qartë forma e dokumente ligjore që duhet të paraqiten për vërtetimin e cilësisë të produkteve që duhet të jenë “Certifikimet e lëshuar nga një organ i specializuar”. Në kuptim të kësaj pike, vetedeklarimet për konformitetin lëshuar nga prodhuesi nuk janë të vlefshme për qëllime kualifikimi pasi Autoriteti Kontraktor e ka cituar qartë llojin e dokumentit të kërkuar e që duhet të jetë Certifikatë Konformiteti ose Certifikatë Cilësie.*

Publikuar në rregjistrin e ankesave më datë 12.01.2024.

## **KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Nënkryetar**

**Fiorent Zguro**

**Anëtar**

**Anila Malaj**

**Anëtar**

**Kreshnik Ternova**

**Kryetar**

**Jonaid Myzyri**